



PËRMIRËSIMI I ASPEKTEVE TË SIGURISË NË BRONXDALE AVE

Bronx Community Board 11

Mars 2021


Puna e mëparshme





Punimet në proces për përmirësimin e kryqëzimit Bronx Park E/White Plains Rd

- Qershor 2018 Prezantim i NYC DOT për Komitetin e Transportit CB 11 mbi problemet ekzistuese në korridorin e Bronxdale Ave, ku kërkohen komente rreth kryqëzimeve të pazakonta
- Shkurt 2020 NYC DOT i prezantoi propozimin e tij Komitetit të Transportit CB 11 lidhur me përmirësimin e aspekteve të sigurisë në kryqëzimin Bronx Park E/White Plains Rd/Bronxdale Ave/Unionport Rd, duke përfshirë korsitë të mbrojtura për biçikleta me drejtim në Bronx Park Greenway
 - Vjeshtë 2020 Zbatimi

Aktivitete ndërlidhëse në komunitet



Ambasadorët në terren të DOT dëgjuan dhe biseduan me qytetarët në hyrje të Bronx Park pranë Unionport Rd, dhe me qytetarët në kryqëzimin midis Morris Park Ave dhe Bronxdale Ave



- Shtator 2018 - Ambasadorët në terren të NYC DOT vizituan dy vendndodhje pranë Bronxdale Ave për të marrë mendimin e njerëzve që e përdorin këtë rrugë
- Përdorues të ndryshëm dhe me moshë të ndryshme u shprehën se kanë udhëtuar shpeshherë përgjatë Bronxdale Ave
- Mosndalimi i automjeteve dhe tejkalimi i shpejtësisë ishin shqetësimet kryesore.

Green Wave: Një plan për të udhëtuar me biçikletë në New York City



Analizë e faktorëve kryesorë që shkaktojnë viktima (2014-aktualisht):

- 60% e viktimave janë shkakuar në kryqëzime; 23% lidhen me ndryshimin e drejtimit (kthimin) të automjetit; 16% lidhen me mosndalimin e drejtuesit të mjetit për të dhënë prioritet kalimi
- Pothuajse 90% e viktimave janë shkakuar në rrugë pa korsi për biçikleta

Rrjeti i korsive të mbrojtura për biçikleta (PBL) në të gjithë qytetin

- Ndërtimi i 30 milje korsish të mbrojtura për biçikleta, çdo vit, në përputhje me një dokument mbi vizionin për PBL-të.

Projekt më i mirë:

- Zbatimi i standardeve të projektit të ri bazuar në praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim rritjen e sigurisë në kryqëzime.
- Vazhdimi i pilotimit të projekteve të reja me analiza sigurie rigoroze

Edukimi dhe informimi:

- Nisja e fazës vijuese të fushatës “Vision Zero” për ndërgjegjësimin e publikut, edukimin e drejtuesve të mjeteve me fokus rritjen e sigurisë së udhëtarëve me biçikletë, si dhe për nxitjen e përdorimit të biçikletave/fuqizimin e rregullave të fushatës rrugore “Get There”
- Edukimi i të gjithë përdoruesve të rrugës mbi përdorimin e sigurt të kamionëve në rrugët e qytetit
- Rritja e numrit të kaskave të dhuruara dhe nxitja e përdorimit të tyre.

Siguri Korsi të mbrojtura për biçikleta

Projekte rrugësh që përfshijnë korsi të mbrojtura për biçikleta me qëllim rritjen e sigurisë të të gjithë përdoruesve

rënie me 15% e aksidenteve me pasojë lëndime



rënie me 21% e lëndimeve të këmbësorëve

në rrugët ku u vendosën korsi të mbrojtura për biçikleta, gjatë periudhës 2007-2017

Lëndimet e përdoruesve të biçikletave u rritën me vetëm 3%,
pavarësisht rritjes prej 61% në numrin e biçikletave

Korsi të mbrojtura për biçikleta

Të dhëna mbi aksidentet përpara dhe pas vendosjes së korsive, 2007 - 2017



Kent Ave, BK



Prospect Park W, BK

Të dhëna nga 25 projekte të veçanta të korsive të mbrojtura për biçikleta, të zbatuara gjatë periudhës 2007-2014, dhe të dhëna për një periudhë vijuese 3-vjeçare. Përfshijnë pjesë të 1 Ave, 2 Ave, 8 Ave, 9 Ave, Broadway, Columbus Ave, Hudson St, Lafayette St / 4 Ave, Sands St, Allen/Pike St, Kent Ave, Prospect Park West, Flushing Ave, Bruckner Blvd & Longfellow Ave, Imlay St / Conover St, Paerdegat Ave. U analizuan vetëm seksione të projekteve që përfshijnë korsi të mbrojtura për biçikleta.

Burimi: Baza e të dhënave e aksidenteve e NYPD AIS/TAMS

Prezantim i përgjithshëm

1. Kushtet ekzistuese
2. Ndryshimet e propozuara në korridor
3. Ndryshimet e propozuara në kryqëzim



Kushtet ekzistuese

1

Siguria


- 179 lëndime në Bronxdale Ave ndërmjet periudhës 2014 dhe 2018
- Gjerësia e tepërt e rrugës së automjeteve dhe kryqëzimet e ndërlikuara krijojnë radhë të gjata dhe vështirësi gjatë kalimit të rrugës nga këmbësorët


Bronxdale Ave (E Tremont Ave për në Bronx Park E, BX)

Përmbledhje e lëndimeve, 2014-2018 (5 vite)

	Totali i lëndimeve	Lëndime të rënda	Vdekje	KSI
Këmbësorë	29	6	1	7
Përdorues biçikletash	8	0	0	0
Persona në automjete	142	10	0	10
Totali	179	16	1	17
Vdekje, 1.1.2014 – 26.12.2020: 1				

Burimi: Vdekje: NYCDOT, Lëndime: NYSDOT. KSI: Persona të vrarë ose me lëndime të rënda






Problemet ekzistuese

1. Numri i ulët i automjeteve që sjell tejkalim të shpejtësisë
2. Drejtime të papërcaktuara në korsi
3. Vështirësi në aksesin e këmbësorëve
4. Mungesë e rrugëve lokale për biçikleta që lidhen me Bronx Park




Numër relativisht i ulët automjesh

- Gërshetimi i rrugëve të gjera me numrin e ulët të automjeteve inkurajon tejkalimin e shpejtësisë
- 84% e automjeteve të vëzhguara udhëtonin mbi limitin e shpejtësisë
- 46% e automjeteve të vëzhguara udhëtonin me më tepër se 5mph mbi limitin e shpejtësisë



Drejtime të papërcaktuara në korsin

- Automjetet që lëvizin drejt manovrojnë për të shmangur ato që kthehen majtas
- Automjetet që kthehen majtas ndiejnë presionin e automjeteve pas tyre që do të lëvizin drejt



Vështirësi në aksesin e këmbësorëve

- Bronxdale Ave është një rrugë diagonale
- Kryqëzimet e ndërlikuara shoqërohen me pika të vështira për kalimin e këmbësorëve



Neill Ave/Antin Pl/Hunt Ave/Wallace Ave

Rhineland Ave/Muliner Ave

Mungesa e rrugëve lokale për biçikleta që lidhen me Bronx Park




Përmirësimi i aspekteve të sigurisë në Bronxdale Avenue

Ndryshimet e propozuara në korridor

2

Ndryshimet e propozuara në korridor



- Vendosja e një korsie për biçikleta për çdo drejtim dhe vendosja e korsive për kthimin majtas
- Vendosja e korsive të mbrojtura për biçikleta dhe parkim, me ishuj të lyer për këmbësorët aty ku është e mundur
- Ripërshtatja e 5 vendeve të parkimit për çdo bllok për të përmirësuar vizibilitetin në kryqëzime (60 vende në total)
- Reduktimi i distancës së përshkuar nga këmbësorët për kalimin e rrugës
- Ulje e rasteve të tejkalimit të shpejtësisë
- Organizimi i trafikut

Shembull i një projekti të ngjashëm: 9th Street, Brooklyn




- Ishujt e lyer për këmbësorët shkurtojnë distancën e përshkuar për kalimin e rrugës dhe ofrojnë një pikë qëndrimi për përdoruesit më të ngadaltë
- Korsitë e dedikuara për kthimin majtas organizojnë trafikun dhe reduktojnë “presionin e automjeteve nga pas”
- Korsitë e mbrojtura të biçikletave janë më të përshtatshme për familjet dhe përdoruesit e biçikletave me më pak përvojë
- Rrugët më të ngushta dekurajojnë tejkalimin e shpejtësisë



Projekt i një kryqëzimi tipik

- Ishuj të lyer për këmbësorët
- Korsi të dedikuara për kthimin majtas
- Korsi të mbrojtura për biçikleta
- Rrugë më të ngushta



Përfitimet për rrjetin lokal të biçikletave

Korsitë për biçikleta në Bronxdale Ave mund të lidhin:

- Bronx Park
- Pelham Pkwy Greenway
- Bronx River Greenway
- Korsitë e biçikletave në Castle Hill Ave (dhe Soundview Ferry Terminal)



Bronx Park

Ndryshimet e propozuara në kryqëzim


3

Kushtet ekzistuese në Bronxdale Ave/Rhineland Ave/Muliner Ave




- Vijat e bardha në pjesën veriore të Rhineland Ave kanë një gjatësi prej rreth 140' (këmbë)
- Vijat e bardha në pjesën jugore të Bronxdale Ave kanë një gjatësi prej rreth 120'
- Rhineland Ave është i pajisur me sinjalistikë; Muliner Ave ka tabelë për ndalimin e automjeteve

Kushtet e propozuara në Bronxdale Ave/Rhineland Ave/Muliner Ave




- Vendosja e ishujve të lyer për këmbësorët për të shkurtuar distancën e përshkuar për kalimin e rrugës
- Shqyrtimi i përmirësimeve të ardhshme kapitale për të mbyllur korsinë e ngadalësimit dhe për të zgjeruar skajin




Kushtet ekzistuese në Neill Ave, Hunt Ave, Antin Pl, Wallace Ave

- Ndërthurje e paqartë ndërmjet kryqëzimeve me sinjalistikë dhe tabelë ndalimi, dhe korsive të ngadalësimit
- Vizibilitet i ulët poshtë strukturës së ngritur të trenit
- Këmbësorët dëshirojnë rrugë kalimi pa vija të bardha: në anën jugore të Bronxdale Ave për të kaluar strukturën e ngritur të trenit, në anën lindore të Antin Pl për të kaluar në Bronxdale Ave




Bronxdale Ave/Antin Pl/Holland Ave




- Shtimi i vijave të bardha përgjatë Bronxdale Ave
- Heqja e korsisë së ngadalësimit në Bronxdale Ave që kthen drejtuesit e mjeteve në Bronxdale Ave
- Reduktimi i distancës së përshkuar për kalimin e rrugës

Bronxdale Ave/Hunt Ave




- Zëvendësimi i korsisë së gjatë të ngadalësimit me drejtim nga lindja që të çon në Hunt Ave
- Vendorsja e vijave të bardha për këmbësorët përgjatë anës jugore të Bronxdale Ave
- Përmirësimi i lëvizjes përreth kolonave dhe strukturës së ngritur të trenit

Bronxdale Ave/Neill Ave/Hunt Ave



- Mbyllja e korsive të panevojshme me tabelë ndalimi nga Neill Ave për në Hunt Ave
- Heqje e ndërthurjes së paqartë ndërmjet sinjaleve të trafikut dhe sinjaleve të ndalimit
- Reduktimi i gjatësisë së vijave të bardha në pjesën veriore, nga 100 në 30 këmbë

Kushtet e propozuara në Antin Pl/Hunt Ave/Neill Ave/Wallace Ave



- Mbyllja e korsive të ngadalësimit me kthim djathtas dhe zëvendësimi i tyre me hapësira të zgjeruara për këmbësorët:
 - Me drejtim nga veriu në Neill Ave për në Bronxdale Ave
 - Me drejtim nga perëndimi në Bronxdale Ave për në Antin Pl
 - Me drejtim nga lindja në Bronxdale Ave për në Hunt Ave
- Vendosja e pikave të reja për kalimin e këmbësorëve:
 - Në anën lindore të Antin Pl përgjatë Bronxdale Ave
 - Në anën jugore të Bronxdale Ave përgjatë Hunt Ave
- Krijimi i hapësirave për parkim dhe për këmbësorët në Hunt Ave dhe Holland Ave

Përmbledhje e ndryshimeve të propozuara

- Reduktimi i tejkalimit të shpejtësisë duke ngushtuar rrugët dhe duke ulur hapësirën e tepërt për automjetet
- Përmirësimi i organizimit të korsive përmes korsive për kthim majtas dhe korsive për biçikleta
- Reduktimi i distancës së përshkuar për kalimin e rrugës përmes ishujve të lyer për këmbësorët
- Vendosja e korsive të mbrojtura dhe të përshtatshme për biçikleta në Bronx Park
- Thjeshtimi i kryqëzimeve të çrregullta dhe përmirësimi i aksesit të këmbësorëve përmes krijimit të hapësirave dhe vendosjes së pikave të reja të kalimit për këmbësorët

FALEMINDERIT!

Pyetje?



NYC DOT



NYC DOT




nyc_dot



NYC DOT

TRAJTIMI PRANË SHKOLLAVE



HUNT AVE DHE HOLLAND AVE



SHPEJTËSITË E AUTOMJETEVE

